



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2022:261751

Datë: 31.12.2024

Numri i dokumentit: 06673213

C.nr.6556/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Përparim Zeka, dhe bashkëpunëtorin profesional Taulant Maliqi, në çështjen juridike kontestimore të paditësve B. B., N. A., F. B., V. S. dhe P. T., të cilët sipas autorizimit përfaqësohen nga V. Z., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme, Polica e Kosovës - Drejtoria e Përgjithshme, në Prishtinë, Rruga “Luan Haradinaj” p.nr, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore në Ministrinë e Drejtësisë të Republikës së Kosovës, me objekt kontesti, kompensim i pagës së 13 (trembëdhjetë), kualifikimit shkollor dhe shujtave, jashtë seancës gjyqësore me datë 19.11.2024, jep këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësve B. B., N. A., F. B., V. S. dhe P. T., ashtu që DETYROHET e paditura Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme, Polica e Kosovës - Drejtoria e Përgjithshme në Prishtinë, që paditësve t’ia paguaj shumat si në vijim:

- a) Paditësit të parë B. B., në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fundvitet 2018,2019,2020, 2021 dhe 2022, t’ia paguaj për çdo vit shumën prej 696.00 €, apo shumën prej 3, 480.00 €, si dhe në emër të kualifikimit shkollor me diplomë universitare, për periudhën nga data 18.11.2018 e deri me datë 31.12.2022, për 50 muaj, t’ia kompensojë shumën prej 174.00 €, e në total të përgjithshëm prej 3, 654.00 €.
- b) Paditësit të dytë N. A., në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fundvitet 2018,2019,2020,2021 dhe 2022, t’ia paguaj për çdo vit shumën prej 609.13 €, apo shumën prej 3, 045.65 €.
- c) Paditësit të tretë F. B., në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fundvitet 2018,2019,2020, 2021 dhe 2022, t’ia paguaj për çdo vit shumën prej 531.90 €, apo shumën prej 2, 659.50 €.
- d) Paditësit të katërt V. S., në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fundvitet 2018, 2019,2020, 2021 dhe 2022, t’ia paguaj për çdo vit shumën prej 583.66 €, apo shumën prej 2, 918.30 €, si dhe në emër të kualifikimit shkollor me diplomë universitare

të nivelit master, për periudhën nga data 18.11.2018 e deri me datë 31.12.2022, për 50 muaj, t'ia kompensojë shumën prej 145.92 €, e në total të përgjithshëm prej 3, 064.22 €.

- e) Paditësit të katërt V. S., në emër të shpërblimit të pagës së trembëdhjetë për fundvitet 2018, 2019,2020, 2021 dhe 2022, t'ia paguaj për çdo vit shumën prej 589.54 €, apo shumën prej 2, 947.70 €, si dhe në emër të kualifikimit shkollor me diplomë universitare të nivelit master, për periudhën nga data 18.11.2018 e deri me datë 31.12.2022, për 50 muaj, t'ia kompensojë shumën prej 147.39 €, e në total të përgjithshëm prej 3, 095.09 €.

II. DETYROHET e paditura Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punëve të Brendshme, Polica e Kosovës - Drejtoria Përgjithshme, në Prishtinë, të ju paguaj paditësve, shumat e gjykuara si në pikën -I- të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me kamatë ligjore në shkallë prej 8 % në vit, e cila fillon të llogaritet nga data 09.12.2022, dita kur është paraqitur padia në këtë gjykatë, e deri në pagesën definitive, si dhe shumën prej 644.00 €, në emër të shpenzimeve procedurale, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes - pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit.

III. REFUZOHET pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësve B. B., N. A., F. B., V. S. dhe P. T., me të cilën kanë kërkuar që të detyrohet e paditura, që paditësve veç e veç të bëj kompensimin e ushqimit (shujtave ditore), për periudhën nga data 14.11.2018 e deri me datë 31.12.2022, në shumë të përgjithshme prej 11,250.00 €, si KËRKESË E PABAZUAR.

### A r s y e t i m

Paditësit përmes përfaqësuesit të tyre, me datë 09.12.2022, ka paraqitur padi dhe kërkesëpadi, kundër të paditurës, për kompensimin e pagës së trembëdhjetë, kualifikimit shkollor, dhe kompensimit të shujtës, duke theksuar se paditësit janë në marrëdhënie pune me të paditurën, dhe meqenëse e paditura nuk ka përmbushur obligimin e saj në lidhje me kompensimin e kërkesave të lartcekura, ka kërkuar nga gjykata aprovimin e kërkesëpadisë.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura me datë 25.10.2023, ka parashtruar përgjigje në padi, me të cilën e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësve, për shkak se nuk ka shterrur mjetet e brendshme juridike, si dhe e paditura nuk ka kompensuar për këtë lloj të drejte asnjë punonjës të policisë së kosovës, kurse kërkesën për paga jubilarë ka kompensuar për paditësit. Ka shtuar se Ministria e Financave në përputhje me nenin 19 të Ligjit nr.07/L-041 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, përkatësisht Ligjin nr. 05/L-125, neni 20 paragrafi 4 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2018, nuk e ka aprovuar kërkesën e Policisë së Kosovës dhe si rrjedhojë, çdo nismë, duke përfshirë edhe atë lidhur me nenin 29 pika 2 të UA nr.02/2018 për Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, i cili prodhon obligime financiare nuk është i obligueshëm përderisa nuk ka identifikuar paraprakisht burimin financiar, ashtu që në mungesë të mjeteve buxhetore – financiare nuk ka mundur të realizohet pagesa e pagës së 13-të. Më propozim për gjykatën që kërkesëpadija e paditësve të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 398 të LPK-së, për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, sepse në mes të palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, që në këtë rast rezulton se padia e paditësit është e bazuar për arsye se:

Me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së) përcaktohet se: “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë.”, lidhur me nenin 4 paragrafi 2 i LPK-së, në të cilin përcaktohet se: “Ndryshe nga dispozita e paragrafit 1 të këtij neni, gjykata vendosë për kërkesëpadinë në bazë të veprimeve procedurale të shkruara dhe provave të administruara në mënyrë jo të drejtpërdrejt, po që se kjo përcaktohet me ligj”.

Ndërsa për pjesën tjetër të kërkesëpadiës, gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 399 sipas të cilit “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”.

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës dhe vlerësimi i përgjigjes në padi, gjykata konstatoi se: Në mes të palëve ndërgjyqëse rezulton se nuk ishte kontestuese se paditësit janë në marrëdhënie pune tek e paditura, megjithatë gjykata këtë e vërtetoi edhe nga vërtetimet e punësimit të bashkangjitura shkresave të lëndës.

Nga vërtetimet e punësimit të cekur më lartë, të cilave gjykata ju fali besimin me rastin e vendosjes sa i për ketë lartësisë së kërkesëpadiës së paditësve, pasi që ka vërtetuar se paditësi i parë realizon pagën mujore në shumë prej 696.00 €, si dhe i njejtë posedon kualifikimin shkollor në nivelin bachelor, paditësi i dytë realizon pagën mujore në shumë prej 609.13 €, paditësi i tretë realizon pagën mujore në shumë prej 531.90 €, paditësi katërt realizon pagën mujore në shumë prej 583.66 € dhe i njejtë posedon kualifikimin shkollor në nivelin bachelor, si dhe paditësi i pestë realizon pagën mujore në shumë prej 589.54 € dhe i njejtë posedon kualifikimin shkollor në nivelin bachelor, ku këto fakte janë vërtetuar nga vërtetimet e marrëdhënies së punës dhe diplomave si mjet provues për vërtetimin e faktit të kualifikimit shkollor, të cilat janë të bashkangjitura në shkresat e lëndës.

Gjykata, vlerëson se në këtë rast duhet të zbatohen dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr. 02/2018, mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës dhe Udhëzimit Administrativ nr. 01/2021, mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës për kërkesat e aprovuara të paditësit, që kanë të bëjnë me kompensimin e pagës së 13.

Me nenin 29 paragrafi 2 të UA nr.02/2018 përcaktohet se: “Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit”.

Me nenin 30 paragrafi 2 të UA nr.01/2021 përcaktohet se: “Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një pagë mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, nëse ka mjete buxhetore”.

Nga interpretimi i dispozitave të lart cituara të Udhëzimeve Administrative, të nxjerra nga e paditura, dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar, sepse paditësit gëzojnë të drejtën që në fund të çdo viti kalendarik ta përfitojnë si shpërblim një pagë mujore, e cila do të jetë ekuivalente me pagën mujore në fund të vitit kalendarik përkatës, me kusht që atë vit kalendarik punonjësit e të paditurës, në këtë rast paditësit, të kenë vlerësim të kënaqshëm të performancës së punës, nëse nuk ju është shqiptuar ndonjë masë disiplinore brenda vitit përkatës. Në këtë rast sipas formularëve të vlerësimit të performancës, që gjenden në shkresat e lëndës, konstatohet se paditësit, kanë vlerësim të kënaqshëm, të performancës dhe të njëjtit nuk i’u është shqiptuar ndonjë masë disiplinore, për gjatë viteve 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022. Për më tepër e paditura nuk ka parashtruar ndonjë vërejtje, me anë të përgjigjes në padi, e që do të vinte në dyshim performancën e paditësve për vitet e lartcekura, e po ashtu nga e paditura nuk është ngritur as çështja e ndonjë mase disiplinore eventuale të shqiptuar ndaj ndonjërit prej paditësit.

Gjykata gjeti se kërkesa e paditësve për pagesë në emër të kompensimit në pagë në bazë të kualifikimit, ka mbështetje në Udhëzimin Administrativ nr. 02/2018 të datës 14.11.2018, ashtu që në nenin 29 pika 3 e këtij udhëzimi të këtij përcaktohet se “shtesat në pagë për kualifikimin shkollor janë si në vijim: 3.1. diplomë universitare, (baçelor, fakulteti) 0.5%; 3.2.master, magjistër i shkencave, 1%; 3.3.doktoratë, PhD 2%.”.

Gjykata nga diplomat e bashkangjitura në shkresat e lëndës në emër të paditësit të parë, paditësit të dytë, paditësit të tretë dhe paditësit të katërt, vërtetoi se paditësi i parë ka marr diplomë të nivelit bachelor andaj si i diplomuar me fakultet të njëjtit i takon kompensimi prej 0.5% të pagës, duke e llogaritur nga data 14.11.2018 – 31.12.2022, për 50 muaj, shumën prej 3.48€ në muaj, në shumë të përgjithshme për 50 muaj në shumë prej 174.00€, apo zbërthyer në vlera monetare (paga bazë 696.00 € x 0.5% = 3.48€), paditësi i katërt ka marr diplomë bachelor, andaj si i diplomuar me fakultet të njëjtit i takon kompensimi prej 0.5% të pagës, duke e llogaritur nga data 14.11.2018 – 31.12.2022, për 50 muaj, shumën prej 2.94€ në muaj, në shumë të përgjithshme për 50 muaj në shumë prej 145.92€, apo zbërthyer në vlera monetare (paga bazë 583.66€ x 0.5% = 145.92€), si dhe paditësi i pestë ka marr diplomë bachelor, andaj si i diplomuar me fakultet të njëjtit i takon kompensimi prej 0.5% të pagës, duke e llogaritur nga data 14.11.2018 – 31.12.2022, për 50 muaj, shumën prej 2.91€ në muaj, në shumë të përgjithshme për 50 muaj në shumë prej 147.39€, apo zbërthyer në vlera monetare (paga bazë 589.54€ x 0.5% = 147.39€).

Gjykata, provave të lartcekura, me të cilat vërtetohen faktet lidhur me marrëdhënien e punës të paditësve tek e paditura, vlerësimet e performancës së punës si dhe lartësinë e pagave të paditësve, ua fali besimin e plotë dhe të njëjtat i pranoi si prova materiale, në kuptim të nenit 329, paragrafi 1, të Ligjit Nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-118, ngase të njëjtat janë dokumente të lëshuar nga vet e paditura. Gjykata, vlerëson se e paditura ka pasur për detyrim sipas dispozitave të lart cituara, që të i'a kompensoi paditësit të parë, paditësve pagat e 13-ta, për fund vitet 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022 dhe kualifikimin shkollor. Andaj paditësit e kanë cilësinë e kreditorëve ndërsa e paditura cilësinë e debitorit, bazuar në nenin 245 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), në të cilin përcaktohet se: “Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”. Prandaj gjykata duke u nisur nga fakti se e paditura ju ka mbetur borxh paditësve me aplikimin e dispozitave të lartcekur dhe në bazë të gjendjes së vërtetuar faktike, vendosi që ta detyroj të paditurën që paditësve të ju kompensoi shumat e gjykuara, si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Për lartësinë e kamatës në shkallë prej 8%, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 paragrafi 2 i LMD-së, dhe Mendimit Juridik për Kamatat i Gjykatës Supreme të Kosovës i datës 02.12.2020, duke filluar me llogaritjen e kamatës nga data 09.12.2022, dita e paraqitjes së kërkesëpadisë në këtë gjykatë, e deri në përmbushjen definitive të detyrimeve.

Gjykata refuzoj kërkesën e paditësve veç e veç në lidhje me shujtat ditore të kërkuara për periudhën nga data 14.11.2018, e deri me datë 31.12.2022, në shumë të përgjithshme prej 11, 250.00 €, pasi që e njëjta kërkesë mbështetet në paragrafin 1 të nenit 29 të UA nr.02/2018 si dhe të nenit 30 paragrafi 1 të UA nr.01 /2021, ku përcaktohet se: “Paga bazë, shtesat për rrezikshmërinë në punë, puna jashtë orarit, gjatë festave, shujtë ditore, veshmbathje (për zyrtarët policorë) dhe sigurim shëndetësor për personelin e Policisë duhet të jetë në përputhje me vendin e punës, gradën, kualifikimin dhe përvojën e punës, duke u mbështetur në Ligjin për Policinë, sistemin e pagave dhe shtesave në Polici”, andaj dispozitat ligjore të lart cituar nuk e detyrojnë shprehimisht të paditurën për kompensimin e shujtave ditore ashtu siç kanë kërkuara paditësit, andaj vendosi si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet e të paditurës në përgjigje në padi dhe gjeti se të njëjtat janë të pabazuara. E paditura nuk mund ta mënjanoi detyrimin, me pretendim se detyrimet financiare nga Udhëzimi Administrativ, se nuk prodhojnë efekt për shkak se nuk janë në harmoni me Ligjin mbi Ndarjet Buxhetore, sepse këto akte në këtë rast Udhëzimi Administrativ i lartcekur, është aprovuar nga struktura të larta të të paditurës, e të cilët e kanë pasur për qëllim edhe motivimin e punonjësve për punë, kur edhe kanë përcaktuar shpërblime për të njëjtit. Për më tepër derisa ato janë qartë të specifikuar, nuk mund të interpretohen në dëm të tani paditësit, duke u thirrur në ekzistimin e mundësive financiare, e as nuk mund të mbetet në diskrecionin e të paditurës se a mundet apo jo për tu përmbushur detyrimet që rezultojnë nga dispozitat e lartcekura për derisa e paditura me asnjë provë shkresore-analizë buxhetore, nuk e argumenton faktin se ka mungesë të mjeteve buxhetore për përmbushjen e detyrimeve siç kanë kërkuar paditësit.

Vendimin qe pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata është në dispozitën nenit 449 dhe 452 e LPK-së, sipas të cilave paditësit ju pranohet shpenzimet në shumë prej 624.00 €, në emër të përpilimit të padisë dhe shumën prej 20.00 € për taksën gjyqësore, ndërsa refuzoj pjesën tjetër të shpenzimeve pasi që të njëjtat, nuk kanë qenë të nevojshme për ndjekjen e çështjes në këtë gjykatë, ashtu siç përcaktohet me dispozitën e nenit 453 par.1 të LPK-së.

Nga se u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË,  
Departamenti i Përgjithshëm  
C.nr.6556/2022, Datë 19.11.2024

Gjyqtari  
Përparim Zeka

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.